



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 60**

**Datë: 21. 12.2020. Ora: 13:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: Kryesues i mbledhjes: Sami Hamiti, anëtarë i KQZ-së.**

**2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**3. Aktivitetet e ZRPPC-së**

- Shqyrtim dhe Miratim i Kërkesës së Partisë Politike Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës për shtyrje të Kuvendit Zgjedhor për gjashtë muaj

**4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**-Këshilli për Çështje Ligjore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Podujevë dhe Istog

**-Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për modernizimin e QNR-së,

-Shqyrtimi dhe miratimi i raportit - rishikimi dhe plotësimi i doracakut për procedurat e votimit

-Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit- punëtori e përbashkët për mësimet e nxëna për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut

**-Këshilli për Buxhet dhe Financa**

-Shqyrtimi i raportit për shpenzime të derivateve dhe kilometrat e kaluara për veturat e KQZ- së;

-Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të pasurisë së KQZ- së;  
-Pagesat e KVV-ve dhe stafit teknik për angazhimin e tyre me datën 14 mars 2020 në Komunën e Podujevës;

## 5. Vlerësimi vjetor për Zëdhënësin e KQZ-së.

## 6. Të ndryshme.

---

### **1.Hyrje: Sami Hamiti, kryesues i mbledhjes.**

**Sami Hamiti:** Sot do ta udhëheqim mbledhjen e gjashtëdhjetë të KQZ-s me autorizimin e kryetares. Rendin e ditës e keni marr. Unë e hapi diskutimin rrethë rendit të ditës. A ka dikush plotësime, vërejtje dhe sugjerime rreth rendit të ditës?

**Alim Rama:** Unë, e kam vetëm një korrigjim rendi i ditës në këshill për operacione zgjedhore nuk është pikë e rendit të ditës siç është rekomanduar prej këshillit për operacione zgjedhore. Pika e rendit të ditës duhet të jetë analiza e të gjeturat prej vendimeve të PZAP-it lidhur me ankesat për përcaktimin e vlefshmërisë, pavlefshmërisë të fletëvotimeve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës me 6 tetor 2019, kjo duhet të jetë pjesë e rendit të ditës jo shqyrtim. Kështu që kisha lutur sekretariatit herën tjetër që pas mbledhjes së këshillave ti dëgjojnë mirë edhe ti aprovojnë që mos ti dërgojnë në mënyrë atëkohë dhe pa konsultim. Pikat e rendit të ditës janë caktuar në këshille për operacione, këshilli për operacione i ka votuar. Kështu që herën tjetër mos ti dërgojmë kështu. Edhe njëherë e kisha lutur mos të na dërgojnë në vindows, sepse po na krijojnë probleme s'mundemi t'i kapim telefonat, është zip, i kemi aplikacionet e tjera. Ju lutem, tre here e kemi përsëritur të njëjtën kërkesë...

**Sami Hamiti:** Shqyrtimi dhe miratimi i raportit dhe shikimi i doracakut. Dokumenti është i saktë siç po thotë Halimi sepse ashtu jemi dakorduar në këshille për operacione. Pas kësaj analize me u pa rishikimi, kjo është faza e parë dhe kështu e kemi trajtuar në këshill për operacione zgjedhore ka të drejt Halimi plotësisht. Do të thotë, të përmirësohet tutje por ne realisht si analizë e kemi vendosur ta diskutojmë. A ka dikush tjetër? Po, urdhëro.

**Burim Ahmetaj:** Tek këshilli për buxhet, i keni disa pika që janë shtyrë për mbledhjen e radhës, këshilli për buxhet...

**Sami Hamiti:** Po, saktë te këshilli për buxhet do të trajtohet vetëm pika e tretë: pagesa e KVV-ve dhe stafit teknik për angazhim në zgjedhje sepse shqyrtimi i raportit dhe shpenzimet e derivateve është larguar sepse materialet kanë ardhur tek në këshillë. Vlerësimi i pasurisë e kemi kaluar atje, po nuk e trajtojmë atje për

shkak se i kemi pasur disa kërkesa nga këshilli për buxhet, do ta trajtojmë në mbledhjen e ardhshme sepse në këshill të buxhetit e kemi kaluar raportin si të tillë, po i kemi pasur disa kërkesa që vijnë me tabela në KQZ pasi që nuk kanë qenë në gjendje deri në mbledhje. Jemi dakorduar që ta shqyrtojmë në mbledhjen e ardhshme, do të thotë edhe dy pikat e tjera për buxhet të hiqen pika e parë dhe pika e dytë.

**Arianit Elshani:** Lidhur me pikën e shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për modernizimin e QNR-s, as Eshrefi as unë nuk e kemi material. Si material, ne e kemi trajtuar në KOZ...

**Burim Ahmetaj:** Krejt varet ju siç doni ta vlerësoni, e keni vlerësimin e zëdhënësit, siç, doni ta trajtoni e gjitha varet nga ju.

**Sami Hamiti:** Problemi, është që ne për ta kaluar nuk kemi nevojë ta kalojmë afatin ligjor sepse besoj që secili e keni pasqyrën e vlerësimit për të nuk është problem. Nëse doni të prisni të jenë edhe dy anëtar të tjerë atëherë e shtyjme e lamë për mbledhjen e ardhshme sepse është edhe kryetarja është edhe Ibrahimimi, në rregull atëherë e heqim pikën e pestë e vlerësojmë në mbledhjen e radhës, në rregull jemi.

**Alim Rama:** Unë e kam një vërejtje tek mënyra e vlerësimit, që vlerësohen prej KQZ-s. Unë mendoj që mënyrat e vlerësimit duhet të jen transparente edhe qëllimi i vlerësimit është që ai zyrtari të përmirësohet vitin tjetër. M'i marr këshillat edhe vlerësimi të jetë transparent mos me qenë vlerësimi i fshehur sepse, për mua qëllimi i vlerësimit është që secili do zyrtar që vlerësohet me pas vërejtje edhe në mënyrë transparente...

**Sami Hamiti:** Kur ti ndërrojmë rregullat dhe procedurën. Ne këto rregulla këto procedura jemi, vazhdojmë tutje. Vahide shkurtë kur i përfundon qasja e vlerësimit të zëdhënësit...

**Vahide Behrami:** Unë e kam bërë njoftimin dhe kursimet vjetore fillojnë në fillim të dhjetorit dhe mbarojnë me 31 dhjetor. Do të thotë deri me 31 dhjetor duhet të përfundoj.

**Sami Hamiti:** Në rregull kjo punë nuk është problem sepse vlerësimin mundemi të bëjmë edhe ndaras edhe pa mbledhje se kemi problem sepse vetëm anëtarët e bëjnë. Në rregull jemi. Ndryshimi tek këshilli për operacione zgjedhore në pikën dy ashtu siç, e propozoj z. Rama. Dy pikat e para dhe e dyta tek këshilli për bugjet dhe financa jemi dakorduar të mos jenë. Dhe pika pesë e vlerësimit të hiqet, me këto ndryshime. Prandaj, kush, kush është për rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

## **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit kryesues. Në pika të shkurtëra po mundohem ta sqaroj. Atëherë raporti aktivitetet e sekretariatit përmban planin e punës të vitit 2020-të dhe zbatimin e tij dhe aktualisht sekretariati është në draftimin e planit për vitin 2021. Mirëpo kësaj, i paraprin dhe vlerësimi i planit të punës fazë në të cilën jemi në aktualisht dhe posa të përfundoj vlerësimi i zbatimit të planit të vitit 2020 atëherë do të mundemi ta kemi draftin nga fundi i këtij viti, që praktikisht javën tjetër mundemi ta kemi draftin e plot të planit të punës për vitin 2021.

I keni edhe këto aktivitetet të cilat janë akoma në proces e sipër dhe të cilat nevojitet të shqyrtohen në këshilla dhe për vendimmarrje në Komision Qendror të Zgjedhjeve, po ashtu draft plani i punës do të jetë i gatshëm besoj që këtë vit do të jetë draft plani i punës i gatshëm në mënyrë që vitin e ardhëm praktikisht deri në gjysmën e janarit të shqyrtohet dhe të plotësohet nga sekretariati dhe pastaj të dërgohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për shqyrtim. Si dhe e keni informatën për angazhimin e stafit për kontratat e tyre që e kemi edhe numrin e stafit që i kemi të angazhuar dhe kontrata e tyre që kanë skaduar me 11 dhjetor.

Për KKZ-në, ka skaduar me 19 dhjetor dhe për një pjesë të stafit do të përfundoj kontrata dhe angazhimi i tyre me 25 dhjetor janë edhe arsytet se pse kemi kërkuar dhe praktikisht departamentet kanë kërkuar për kryerjen e disa punëve pas procesit zgjedhor. Ndërsa pjesën më të madhe të këtij stafi që mbetet i angazhuar është stafi në QNR dhe depo të cilët do ta sistemojnë materialin zgjedhor dhe të rregullohet gjithçka dhe pastaj ta përfundojnë punën e tyre.

Pra, në pika të shkurtëra këto janë disa nga aktivitetet e sekretariatit, faleminderit.

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryeshef. A ka dikush pyetje? Po urdhëro...

**Alim Rama:** Unë vetëm edhe njëherë: A e ke nënshkruar aktemrimin Burim? Unë nuk e di me çfarë parametra je këtu, realisht. Tre muaj kaluan, unë e di me çfarë statusi je këtu. A mundesh ta shpjegosh atë...?

**Sami Hamiti:** Nuk ke nevojë të përgjigjesh, vazhdojmë tutje...

**Alim Rama:** Pyetja nuk ka qenë, e kryesuesit por Burimit. A e ke nënshkruar aktemrimin? Sepse, unë nuk po e shohë me çfarë rregulle je këtu, realisht.

**Eshref Vishaj:** E gjithë kjo çështje, është e banalizuar përtej gjitha parametrave të punës normale që ne e kemi këtu. Nuk është kryefjala procedura e kryeshefit në çdo takim. E dyta, me siguri ti je njoftuar për masën e përkohshme që e ka dhënë gjykata lidhur me procesin e krye shefit të ekzekutivit. Je i njoftuar, mbi këtë bazë është pa objekt deri në vendimin e gjykatës, kaq.

### **3.Aktivitetet e ZRPPC-së**

**Yll Buleshkaj:** Faleminderit kryesues të nderuar anëtar. Ashtu siç e dini, ne jemi në proces përmbyllës të aktiviteteve për vitin që e kemi kaluar. Përveç punëve që kanë qenë të ndërlidhura direkt me zgjedhje i kryejmë punët që janë për periudhat jo zgjedhore një nga to është edhe pranimi i kërkesave të ndryshme nga partitë politike. Ashtu siç i keni parë materialet që i keni pranuar në email, ashtu edhe ato që i keni para jush me datën 09 të këtij muaji e kemi pranuar një kërkesë nga Partia Demokratike e Aashkalinjëve të Kosovës të cilët kanë kërkuar tju shtyhet afati për mbajtjen e kuvendit zgjedhor të tyre për gjashtë muaj.

Arsyetimi është sepse nuk janë lejuar të mbajnë kuvend dhe pse i kanë pasur gjitha procedurat e kryera. Këto na e kanë dëshmuar sepse fillimisht na kanë lajmëruar dhe për datën e mbajtjes dhe pastaj nuk kanë mundur ta gjejnë një vend që ka mundur ti lejojnë ta mbajnë me 61 persona sa e kanë me statut në një vend. Kështu që me shpresën që do të ketë kushte më të mira pas 6 muajve atëherë kanë kërkuar që të shtyhet ky afat, ne e kemi praktik që kemi shtyer aftin e mbajtjes së kuvendit për 6 muaj edhe për partitë e tjera më herët, kështu që kemi rekomanduar para jush që praktika e njejtë të vazhdohet edhe me këtë parti e cila është jo parlamentare. Ju faleminderit.

**Sami Hamiti:** Faleminderit Yll. A ka dikush vërejtje, komente? Urdhëro.

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryesues! E para po ju marr shumë lakmi që ju kanë parapri kësaj kërkesë që e kanë tejkalluar afatin kërkesës për shtyerjen, edhe më erdhi mirë pasi që i kanë tri javë ne dispozicion për ta mbajtur këtë kuvend kështu që në parim edhe e mbështes ashtu sic i kemi mbështetur edhe rekomandimet e tjera me shtyerjen e afateve për kuvende.

Yll Buleshkaj: I kemi rekomanduar gjitha partitë që i kanë afatet afër që mos të presin momentin e fundit sepse edhe ne e dimë që nuk mundemi të organizojmë mbledhje të KQZ-s cdo moment. Në mënyrë që t'ju ikim këtyre, i kemi rekomanduar që këto kërkesa të bëhen diku dy javë më herët kur është e mundshme. Edhe pse kemi pasur afate që janë tejkalluar po prapë se prapë ky ka qenë rekomandimi jon, që të shikohen gjitha mundësitë. Kanë kontaktuar edhe me disa informata që i kam edhe me Ministrin e Shëndetësisë që ju kanë thënë që nuk pritet të reduktohen masat sidomos në këtë periudhë edhe pas vitit të ri nuk e di as burimet kush janë tek Ministria e Shëndetësisë dorën në zemër, por ashtu më kanë thënë.

Edhe ne' i kemi pranuar si të mirëqenë nuk kemi pas arsye mos tju besojmë, ju faleminderit.

**Sami Hamiti:** Vazhdojmë me raportet e këshillave... !

#### **4.Raport i Këshillave të KQZ-së**

## **1.Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Podujevë dhe Istog:

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryesues, një sqarim: është edhe e Podujevës, është e dyta. Është mirë ta sqarojmë a ka pasur kuotë, tejkalim për z. Kurteshi te ajo e para e javës së kaluar. Këshilli për çështje ligjore ka shqyrtuar kërkesat për zëvendësimin e anëtarëve komunal në Podujevë dhe në Istog dhe me qenë se tri kërkesat kanë kaluar të gjitha filtrat ligjore ka rekomanduar që të aprovohet edhe në KQZ dhe të zëvendësohen këta anëtar të kuvendeve komunale.

Për njërin prej tyre, shprehi edhe ngushëllime për familjarët e Istogut që ka humbur jetë në moshë shumë të re. Do të thotë, këto janë kërkesa për zëvendësim andaj rekomandoj që të aprovohen, faleminderit.

**Sami Hamiti:** Faleminderit Arianit. Kush është që Bahri Blakqori të emërohet anëtar komunal në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Avni Fetahu.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim për zëvendësim.

**Sami Hamiti:** Kush është që Kasim Bashota të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetvendosje, duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Pajtim Balaj. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim për zëvendësim.

**Sami Hamiti:** Kush është që Blerim Hyseni të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, duke zëvendësuar anëtarin komunal të ndjerin Labinot Alijaj.

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë rekomandim për zëvendësim.

**Sami Hamiti:** Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

## **2.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për modernizimin e QNR-së:

**Alim Rama:** Faleminderit z. Kryesues, para jush e keni një dokument, dhe unë sa për informatë ju kisha njoftuar të gjithë KQZ-n që i njëjti dokument me ndryshime shumë të vogla, u refuzua njëherë nga këshilli për operacione zgjedhore për shkak të mangësive në informata. Ky dokument, u aprovua me ndryshime minore në mbledhjen e fundit dhe unë mendoj që aprovimi ka qenë totalisht anëson. Dokumenti nuk i përmbush kushtet të një strategjis. Në objektivat që janë krejt në rregull, që janë thjeshtësimi dhe modernizimi në QNR pritja e transparencës dhe

përshpejtimi i databulimit të rezultateve. Në bazë të këtyre objektivave në mbledhjen e par të KOZ-it që ka qenë duke u trajtuar ky dokument ka thënë që nuk i sqaron objektivat përveç nuk sqaron mënyrën veprimet strategjike që i merr QNR-ja dhe sekretariati për ti realizuar këto objektiva në vend të saj i kemi analizën e gjendjes së tanishme dhe funksionimit të QNR-s.

Kemi rekomandimin për t'u ndërruar që janë të tu ndërruar pajisjet sepse, pajisjet ndërrohen për shkak të vjetërsisë edhe vendosja e disa barkodeve ne materiale që është një veprim i duhur. Por larg prej asaj që ky dokument përmban një strategji. Pavarësisht kësaj për shkak të politizimit ky dokument u votua për së dyti në KOZ gati pa ndryshime substanciale që ka qenë kërkes herën e par. Kështu që KOZ-i me tri vota për ka rekomanduar që ky dokument të pranohe dhe një kundër. Por, unë mendoj, keni dokumentin, unë e dhashë mendimin tim...

**Sami Hamiti:** T'i e jep mendimin e këshillit, jo mendimin tënd. Për ndryshe përjashtohesh, thua se e ndan mendimin ndryshe...

**Alim Rama:** Unë e informova KQZ-n që I njëjti dokument u refuzua në këshill për këto arsye. E kemi refuzuar tash i njëjti dokument u aprovua pa asnjë ndryshim gati përveq ndryshimeve gjuhësore. Së dyti unë e jap edhe mendimin tim për këtë dokument, unë e thash që këshilli me tre vota për e ka rekomanduar dhe një votë kundër. Por qoftëse e lexoni dokumentin si anëtar i KQZ-s jo si kryesues i këshillit, ky dokument larg prej asaj që ti përmbush kushtet të një strategjisë.

Ky dokument u aprovua për shkak të politikës për përkrahje të individëve të caktuar edhe përmbushjen e planit vjetor, ky dokument nuk ka asnjë element të strategjisë. Unë nuk po shoh çka po mbërrin sekretariati me çfarë synime po dëshiron të arrij me këtë dokument sepse ato nuk është e qartë.

Dokumenti, ka një emër shumë të rëndësishëm strategjia për modernizimin e QNR-s, ndërrimi i pajisjeve që janë të vjetra 10 vite e më shumë ai nuk është plan strategjik ai është veprim i rregullt i secilit do institucion. Vendosja e barkodeve, është një gjë që secili element formularët e ndjeshëm mirë është ti kenë barkodet që të mund të gjurmohen edhe përshpejtohet procedura. Por, unë përveç kësaj nuk pash asnjë vendim strategjik.

**Sami Hamiti:** Faleminderit Halimi! Unë kam pyetje për ty. Cilat janë ato veprime që duhet për tu marr edhe të bëhen në të ? Sepse, nuk ka për të thënë nuk ka asgjë, cilat janë ato që i propozon dhe i fusim ne këtu në KQZ i fusim ato strategji. Propozoj, listoj një nga një, çka duhet të kemi aty dhe po i fusim.

**Alim Rama:** A i ka treguar dokumenti cila është gjendja e tanishme ne QNR? Studim strategji duhet ta kemi, çka po duam të synojmë a po duam ta zvogëlojmë kohën e certifikimit të rezultateve. Cilat vendime duhet ti marrim për ta zvogëluar kohën ato janë. Ky dokument është larg prej asaj që mundet të thirret strategji edhe njëherë siç, e kam thënë në KOZ ju mundeni ta aprovoni këtë dokument por secilin dokument që e aprovon KQZ-ja duhet të jetë publik dhe të dihet autori se nuk

mundemi të aprovojmë dokumente vetëm pse duhet të mbushet orari i punës, plani vjetor por duhet ti mbushim edhe çfarë është plani strategjik.

**Sami Hamiti:** Z. Halim, ke pasur kohë prej ditës që e kemi shqyrtuar ti bëjm propozimet ti qesim këtu pasi që ti po i din të gjitha nuk është problem ka këtu njerëz që nuk i dijnë i sjell i propozon edhe i fusim ne nuk është problem nuk ka për të thënë. Cilat propozime tua me i fut dhe ne po i fusim, cilat janë. Nuk ka për të thënë nuk ka. At dit ke thënë nuk ka objektiva se nuk e kisha lexuar fare. Unë kërkova falje se nuk e kisha lexuar. Ti për të thënë duhet, unë mendoj që kjo, kjo, kjo, ne i shqyrtojmë.

**Alim Rama:** A të fillojmë çka duhet së pari. Rekomandimet e mia që dokumenti njëherë me pas procedurat e qarta të QNR-s të aprovuara prej KQZ-s, unë këtu nuk i pas në ueb-faqe nuk i pash procedurat e QNR-s. Së dyti... Arianit ti duhet ta kuptosh procesin, tregomëni njëherë dikush prej jush a e kuptoni pas këtij vendimi procesin e QNR-s.

**Arianit Elshani:** T'i, është mirë ti kapësh e ti dëgjosh ato procesverbale të mbledhjes së KOZ-it i merr i dëgjon të gjitha edhe e sheh çfarë kam thënë në KOZ aty e po besoj që më së shumti ki nevojë për atë. Ky material që kuptimin e strategjisë si strategji e ka kuptimin e gjon të strategjisë së QNR-s, nuk po flasim për strategji të QNR-s po flasim për strategji të modernizimit dhe është koncept pak më i ngushtë se ajo çka po flet ti. Dhe si koncept i ngushtë unë edhe në mbledhjen e kaluar e thash që janë persona me përvojë si Haku si Burimi si administrata në përgjegjësi e kanë një përvojë këtu në KQZ, e kanë një përvojë me procese zgjedhore e dijnë se çka e vonojnë një proces qoftë të numërimit qoftë të certifikimit qoftë të menaxhimit të administratës e kanë një përvojë brenda nuk mundesh ti tja mohosh të vish sot e ti mësosh këtu.

Unë, pajtohem me ty në kuptim të gjerë që ka nevojë për procedura ka nevojë për udhëzime administrative ka nevojë për protokolle, por po flasim për një koncept më të ngushtë dhe këto janë evidente. Ti e she që është mjaftë konkrete dhe si të tillë e ke parë e kemi rekomanduar ta aprovojmë sot. Unë e kam një pyetje se ndryshe nga parafolësi që nuk rekomandoj asgjë për ndryshim unë kam pyetje në lidhje me 5.3 ndryshimi i dizajnit të listës, kështu që është ta kuptojmë mirë z. Rama.

Listën përfundimtare të votuesve e kemi përdorur një format A3 në këto zgjedhje, e keni pilotuar. Si janë rezultatet e asaj a mundet të praktikohet dhe a mendoni të vazhdohet e tillë, qofse jo atëherë ju lutem ndryshon këtë në përmbajtje. Faleminderit.

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit kryesues. Ne, e kemi pilotuar në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe formati A3 pos që e ka formatin shumë të madh edhe koston e ka edhe njëher më të madhe. Kështu që me një ndryshim të dizajnit praktikisht e kemi parë që nuk mundemi të arrijmë një objektiv të qartë që e rrit edhe efikasitetin por edhe e zvogëlon koston. Kështu që nuk kemi nevojë të shkojmë me një format të till që e kemi rekomanduar por mirë që e kemi pilotuar



dhe e kemi parë që një format A3 e rrit koston edhe njëherë më shumë edhe nuk është praktike. Praktikisht, i bije që të jetë në formatin aktual që është, faleminderit...

**Sami Kurteshi:** Faleminderit pak po më duket si pa tolerancë. Kur flet njeri ndëgjone, mos u pajtoni. Unë nuk pajtohem me asnjë nga ju, por megjithatë me ju ndëgjua mendoj që është shumë e drejt. Sa i përket tekstit strategjia e modernizimit të QNR-s. Nuk e di a e ndëgjua kolegun Arlind me kujdes, por unë po ua them juve vetëm një pikë, kujdes e keni dokumentin përpara lexojeni, merreni tek objektivat. Pika 3, strategjia përfshin një periudhë tri vjeçare ndërsa plani i veprimit është bërë për dy vitet e para.

Tri objektiva kryesore modernizimi dhe thjeshtimi i proceseve, rritja e transparencës, përshpejtimi i tabolimit të rezultateve. Janë tri objektiva kryesore, plani i veprimit është për dy vite kurse strategjia është për tri vjet, nuk po di si ta kuptoj. Njëherë në paragrafin tjetër thotë objektivi kryesor i strategjisë, jo këtu janë tri objektiva kryesore. Ose është një ose janë tri, këtu janë tri. Mirëpo edhe këtë po e lë, ja nis objektivi kryesor i strategjisë modernizimi, thjeshtimi i procesit objektivin e dytë nuk po e shoh askund rritja e transparencës.

Objektivi i tretë përshpejtimi i procesit të tabolimit kur i numëron me numra thua objektivi i parë, modernizimi dhe thjeshtimi e sqaron këtë, këtë. Pajtohem s'pajtohem, propozojmë të ndryshojmë unë pastaj as nuk po di si të propozoj ta ndryshoj sepse nuk po e di pikën e ndarjes. Rritja e transparencës, nuk e di a është e përzier por unë nuk e kuptova askund por si pikë të veçantë nuk e gjeta askund, rritja e transparencës unë e marr me mend që shiko këtë punë e kemi bërë ne edhe a po e shihni e gjithë bota. A është transparente? Po. A ka hile? Po. Se këtu është puna tek hilet, s'ka hile.

Shkojmë te tjetra, punë e thjeshtë. Edhe e treta, përshpejtimi i tabolimit të rezultateve. Pastaj është plani i veprimit unë e shikova planin e veprimit, në fund e pash një tabelë ku shkruan, kalendari për zbatimin e aktiviteteve të propozuara. Nuk ka afat nuk ka asgjë po thotë dy vite, me marr me shikuar edhe njëherë me kujdes e me rregulluar bash ato që i keni shënuar ju vet, jo unë çka po propozoj me i qitë. Rritja e transparencës nuk kemi asgjë, rritja e transparencës ka të bëjë me futjen e kamerave, jo nuk ka kamera. Jo futjen e vëzhguesve, jo nuk ka vëzhgues, po më tregon çfarë ka, unë e di. Rritja e transparencës do të thotë të dihet gjithçka cka po bëhet këtu. Rritja e transparencës janë kamerat i instalon këtu, ne e mbajmë mbledhjen, herë pajtohem herë nuk pajtohem por të gjithë e shohin çka është duke u bërë. Ajo është rritja e transparencës nuk mbetet asgjë publike e fshehur. A i bie ashtu apo jo?

Unë nuk po e kuptoj. Prandaj unë e morra vetëm një pikë për ta treguar që së paku këtë që e ke shkruar këtu mirë është t'ju përmbahesh. Sepse këtu thotë, kjo strategji është e shoqëruar me një plan të veprimit e bashkangjitur strategjisë dy vite, strategjia është tri vite. Unë për veti ju propozoj merreni rishikojeni është dokument i joni, i KQZ-s në fund të fundit ne do të punojmë me të edhe SKQZ-ja se na në

KQZ mundemi të bëjmë zhurmë na i sjellin, ne i shikojmë, i lexoj, pajtohem nuk pajtohem. Por e di saktësisht çka ka në dokument. Këtë më ke thënë që është, këtë e kërkoj me këtë nuk pajtohem, me këtë pajtohem, kjo është. Leni të bisedojnë njerëzit, le të shprehen, ne nuk kemi asgjë për vetëm këtyre mbledhjeve. Faleminderit.

**Sami Hamiti:** Kryeshef a keni ju më ndonjë gjë për të shtuar. A keni mundësi të shtoni ndonjë gjë në dokument? Urdhëro.

**Eshref Vishaj:** Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Unë I dëgjova me vëmendje dy parafolësit, por si duket nuk është e përpunuar mjaftë mirë nga ana e z. Rama, strategjia. Me qenë se edhe unë ndaj mendimin se duhet të jetë një dokument më sqarues pak, më konkret ku dihet se strategjia ndërtohet mbi bazën e një analize funksionale të instucinit ose shërbimit, konkretisht të Qendrës së Numërimit të Rezultateve që e ka përcjell ndër vite. Unë e kam lexuar edhe më herët dhe tani, ju i keni evidentuar akcentin kryesor e veni tek ndryshimet apo ndërrimi i teknologjisë që përdoret në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve pak a shumë aty për arsyeje se keni potencuar se proceset në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve kanë pësuar ndryshime në funksion.

Këto procese bazuar në procedura kanë avancuar në funksion të përpunimit, gjatë procesit të punës në QNR kanë pësuar modifikime prej vitit në vit, kështu që vetëm janë të cekura ndërsa nuk është dhënë edhe sqarimi lidhur me këto kërkesat që i keni evidentuar në strategji.

Transparenca, me qenë se është e evidentuar si objektiv por nëse lexohet në përmbajtjen e saj pak më tutje e gjeni për shembull shumë aktivitete, identifikimi i përpjekjeve të dyfishuara edhe akcenti vihet tek publikimi i FPR-ve dhe FKR-ve në faqen e Komisionit Qendror të zgjedhjeve që në njëfarë forme është edhe transparencë e punës që bëhet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Po ashtu edhe unë e kam vërejtur atë që e tha Samiu pak më herët.

Unë mendoj se, plani i veprimit strategjik duhet të jetë kompatibil në përputhje me afatin e strategjisë e jo strategjia si dokument i veçantë e ka një afat tre vjeçar ndërsa plani i veprimit shkurtohet në dy vite. Atë që e kërkojnë parafolësit e mi unë besoj që është pjesë e planit të veprimit strategjik që nuk është ky plan i veprimit këtu, se plani i veprimit strategjik ka kuptimin e identifikimit të objektivave dhe përzgjedhjet e aktiviteteve për arritjen e objektivave këtu nuk i shohim ato me qenë se ne presim edhe një dokument tjetër që do të bashkëngjitet kësaj strategjie dhe përcaktohet dhe precizohet gjdo aktivitet dhe kush është përgjegjës dhe afatet brenda të cilit do të bëhen ato aktivitete dhe kostot eventuale financiare për implementimin dhe strategjik të strategjisë para vetit.

**Sami Kurteshi:** Ajo që duhet ta keni parasysh dy tre vende apo një vend thotë procesi i rinumërit zgjat shumë, 45 dit apo nuk di sa. Por nuk është me rëndësi 30 dit, 50 dit, ajo mundet me qenë një prej objektivave. Shkurtimi i kohës së rinumërimit, një objektiv e fut kemi këtë përvojë këto zgjedhje këto zgjedhje kanë

zgjatur ka 30, 45, 25. Një prej objektivave shkurtimi i kohës, këtu e ke përshpejtimi i procesit të tabolimit të rezultateve nëse e ke futur këtu rregullojeni, tregomë. Unë vetëm dua me pas, unë po e them unë nuk jam njohësi më i mirë i proceseve zgjedhore e i këtyre, nuk jam. Ky dokument përveç meje që në njëfarë mënyre jam injorant në procese zgjedhore e ka për detyrë mua të ma shpjegoj, të me thotë hej kështu është puna që kjo është strategjia, ky është qëllimi, këto janë objektivat, këto janë mjetet me të cilat unë po dua të arrij dhe këto janë rrugët. Strati është rrugë, pak më e e gjatë për të arritur në një qëllim i caktuar asgjë më shumë, rrugë tjetër nuk ka këtu këtu e kuptoj por nuk e kuptoj këto tjerat.

Unë për vete, ju kisha propozuar merreni rishikojeni me kujdes, shikojeni, rregullojeni, përputheni le të bëhet kompatibil. Fjalinë që e ke shkruar vet ose kushdo, unë po të drejtohem ty, fjalinë që e ke shkruar vet plotësoje në pjesën tjetër arsyetoje, sqaroje edhe unë e kam të qartë asgjë tjetër nuk ka.

**Burim Ahmetaj:** Është e vërtet që i mungojnë aktivitetet, po këtë do ta plotësojmë si komision që kemi punuar bashkë. Dhe sa i përket transparencës më shumë ndërlihet në tërësi e gjithë raporti në Qendrën e Numërimit lidhet me transparencë. Mirëpo ajo që ndërlihet ka të bëjë edhe me futjen e barkodave apo skanimin e barkodeve. Në të gjithë formularët e rezultateve i regjistrojmë në sistem manualisht. Kështu që secili proces mundet të vëzhgohet nga vëzhguesit.

Mirëpo, çka shkruan, cilin barkod e shkruan namualisht nuk mundet ta shoh vëzhguesi, mirëpo me procesin e skanimit është shumë e lehtë por edhe e rrit transparencën sepse ti ke vetëm me skaner ta skanish barkodin e cilit do formular të rezultateve dhe regjistrohet në monitor ku vëzhguesi mundet shumë lehtë me pa a je duke e shkruar atë vendvotim apo jo. Kështu që është një element shumë i padukshëm që rrit transparencën e këtij procesi do të thotë me skanimin e barkodeve.

**Sami Hamiti:** Ne po flasim për kohë, për njohës të procesit. Koha nuk determinohet vetëm nga koha e QNR-s, determinohet edhe nga koha e PZAP-it dhe gjykatës, 52 ditshi i fundit i zgjedhjeve të fundit deri në certifikim të rezultateve është tipike e PZAP-it edhe gjykatave deri në fund. Deri na ato vendimet e gjykatave që kushtetuesja i hodhi poshtë. Do të thotë 52 ditshi nuk është rezultat pse janë vonuar këta në QNR kurrsesi është problem i vendimeve që kanë shkuar 1.400, 1.500 kuti në rinumërim edhe ato kur, me një kohë. E merr një vendim PZAP-i kthehet, ta kthen supremja, kthehet kjo e dërgon në anën tjetër.

Dhe se, stërzgjatja është vendimet që nuk varen prej KQZ-s, shumica absolute që është fatkeqësi në anën tjetër kjo pjesë e modernizuar e votimit që ka nevojë secilën herë të bëhet e mund të shtohet në këtë anë, por strategjia për modernizim, jo strategjia e zhvillimit dhe e QNR-s. E kësaj pjese me plan të veprimeve të aktiviteteve që tha Eshrefi për t'u plotësuar është kjo tjetër këta edhe nuk dijnë të bëjnë më mirë, duhet ta dimë atë punë kaq janë po mundohen këtë anë pak secili për qejfe tona jemi duke folur, secili po flasim herë për strategji herë për objektiva, herë për aktivitete që nuk po ja qëllojmë.

**Sami Kurteshi:** Nëse t'i po thua rinumërimi nuk është faj unë nuk thash rinumërimi është faj i tij. A qenka problem rinumërimi? Sekretariati le te bëjë një analizë të rinumërimit të votave, ne nuk kemi analiza. Edhe saktësisht e dimë për këtë arsyeje, për këtë arsyeje.

**Arianit Elshani:** I konsumuar disa prej çështjeve që desha ti trajtoj që ke realisht me këtë nuk ishim duke folur që e the ti më konkret lidhur me strategjinë. Nuk jemi duke folur për strategji të QNR-s, jemi duke folur për strategji të modernizimit konkrete. Dhe tjetra dua të them për strategji të QNR-s pa pas strategji të KQZ-s. Ne nuk mundemi me marr me bo strategji këtu të një departamenti tjetër, të një departamenti tjetër, veç e veç pa e pasur ne strategjinë e KQZ-s që na determinon në një far forme pastaj edhe planet e punës dhe këto çështjet e tjera. Kështu që unë këtu e kam problemin, për këtë kisha dashur ti jap mbështetje këtij dokumenti që e kemi para vetës me këto të meta që i ka.

Secili, i kemi dhënë komentet e tona se mos të mendojmë që këtu pasqyrohet dikush ka komente e dikush nuk ka por të gjithë i kemi dhënë komentet tona edhe me çështjen e planit të aktiviteteve edhe me planin e kostos që duhet të përfshihet duhet me u parapa krahas planit të buxhetit e të gjitha këto. A duhet të ketë plan veprimit? Duhet të ketë, duhet të dihet kush kur e përfundon specifikisht një objektiv konkrete. Ajo duhet të bëhet, unë komentin tim e dhashë në lidhje me atë pikë, morra sqarimin atë ndryshim, me atë ndryshim unë ja për e mbështes këtë strategji që na është dhënë para vetës, kaq kryesues. Faleminderit.

**Sami Kurteshi:** Se..., po e dëgjoj kolegun Elshani që po e përmend strategjia e modernizimit dhe strategjia e QNR-s. Edhe tash një pyetje e imja se tash edhe pak kam dal jashtë binarëve. Cila duhet të ishte strategjia e QNR-s vetvetiu. A duhet të ketë strategji të QNR-s, apo strategji të një veprimi. Sepse a ekziston vetvetiu një strategji e QNR-s si e tillë. Për mua është edhe kjo çështje, unë po e ngriti a ka vetvetiu kuptim strategji e QNR-s, apo e veprimeve brenda QNR-s sepse nëse është një strategji e KQZ-s ku futet edhe QNR-ja ajo është diçka tjetër. Nëse vetëm këtë ma sqaron, ma bënë dallimin mes kësaj dhe kësaj. Sinqerisht.

**Arianit Elshani:** Kolegu Rama më herët e përmendi për bazën ligjore që ka me u krijuar. Për bazën, për udhëzimet kohore për të gjithë ato. Duhet të parashihet më e gjerë, nëse dëshirojmë të ndryshojmë nuk është aq e ngushtë a e din. Nuk i ke vetëm këto elemente qe duhet ti ndryshosh në QNR.

**Burim Ahmetaj:** Faktikisht strategjinë e bënë instucioni, ne jemi duke dashur ti ndryshojmë, modernizojmë disa procese të brendshme, asgjë më tepër. Se KQZ-ja është ajo që e bënë strategjinë për secilin departament. Nuk ka QNR-ja është pjesë e sekretariatit nuk e ndajmë, nuk guxojmë as ta bëjmë një ndarje jo QNR-ja vetëm, jo departamenti vetëm. Po ne vetëm disa operacione po mundohem ti modernizojmë në raportin edhe transparencës edhe të saktësisë sepse kemi raste kur nuk na shkruajnë. E ka para syve në vendvotim, numrin e vendvotimit edhe në

fletën e ne formular e shkruan gabim, e pastaj kjo na sjell telashe vazhdimisht në Qendrën e Numërimit vazhdimisht që një dokument deri në arkivim ka për të kaluar nëpër 7-8 duar, e i njëjti problem na vazhdon. Kështu që me barkode eliminojmë këtë problem.

**Eshref Vishi:** Tani, të mos të ndikohemi të strategjit sektoriale brenda KQZ-s, unë për mendimin tim do ju jepja një këshill do të duhej të përfshihen në kuadër të strategjis se Komisionit Qendror të zgjedhjeve që e kemi filluar me be këtë vit dhe nuk është përfunduar, duhet me hartuar vitin e ardhëm. Mirëpo po besoi se përsëri disa projekte që i kemi than këtu duhet me qenë përsëri pjesë e strategjis , që të hartohet ajo.

**Alim Rama:** Vetëm desha te kthehem të 3 objektivat kryesore, mordenizimi dhe thjeshtimi i proceseve ne QNR gjithsesi janë të mirë së ardhura, por unë nuk e pash në dokument që të shpjegohet se si behet ajo, rritja e transparencës po ashtu edhe ajo është e mirë së ardhur, për mua të kishim pasur një shpjegim te proceseve, seunë nuk kisha pasur nevojë të shkoj në QNR me i pa sepse tash kam shkuar në QNR dhe kam dëshmuar atë bindjen që e kam pasur më herët. Unë, nuk kam nevojë me shkuar në QNR që me pa që nuk ka raport. D.m.th rritja e transparencës është a i jep di ndokujt procedim të të dhënave që vëzhguesit të shohin se si procedohen ato, më than që kanë me u krijuar një stacion, ku vëzhguesit të subjekteve apo të organizatave të tjera që ata të shohin që ato operator janë duke u futur në vende si duhet, që kane më e be krahasimin në mënyrë të rregullt.

A kemi ne raport të transparencës që jepet në mënyrë automatike që, nuk kam nevojë unë ty të te pyes. Raporti i progresit, ku jemi në këtë moment që shkojmë në QNR, duhet të shohim një tabelë.

Gjithmonë, ka pasur një raport që janë në proces rregullat në këtë hap, kemi përfunduar deri këtu dhe më pas një pritshmëri dhe këto janë raporti i progresit të proceseve brenda QNR-s që nuk e ka. Edhe këtu nuk pash se cilët hapa po merren, tani është në rregull të kishim than Okei...

Unë, thash në fillim që pajisjet më qenë gjithmonë një hapë më kohën. Nuk bane qe para 10 viteve mos ti përdorim, por nuk është ai veprim strategjik, ai është veprim i rregullt. Përsheptimi i procesit të abolimit të rezultateve, a po na merr shumë kohë ? apo janë shumë pak tavolina, duhet të ketë me shumë. Është historia për 10 vjet e fundit që ne përafërsisht 50% të vendvotimeve rinumërohen, ndoshta ne duhet me e përgatit një hapësirë tjetër ose një mënyrë tjetër të rinumërimit. Unë atë nuk e pash për këtë qellim po them që dokumenti kur i cekim këto objektiva duhet të na tregoni si kemi me i arrit ato, e ky dokument nuk i ka ato të dhëna. Kështu që unë kisha rekomanduar që kjo të kthehet në ripërpunim.

**Burim Ahmetaj:** Faktikisht raportimin në mënyrë progresive e bëj në mënyrë para vëzhguesve dhe kush ka qenë i interesuar ka pasur informacione përveç rezultateve, vetëm për rezultatet e votave me kusht dhe me post në mënyrë progresive dhe ato të rinumërimit i kemi publikuar, ndryshe rezultatet e procedimit

në mënyrë progresive nuk i kemi publikuar se varet nga vendimi i KQZ-ës. Mirëpo informacionet tjera gjithmonë i kemi dhen dhe nuk kemi pasur nevojë të i shtim në strategji kur veç i kemi ato elemente, kështu që nuk po shoh unë asnjë mënyrë që mundet me pengu një kërkesë për një modernizim të disa aktiviteteve duke ju referuar rinumërimin ato behën manualisht nuk kemi ndonjë procedurë tjetër që mundet me bë ma shumë moderne. Kështu që unë mendoj që dokumenti si i tillë më këto plotësime kishte qenë mirë që të miratohet prej KQZ-s.

**Samir Hamiti:** Unë, pas gjithë këtyre diskutimeve, e vendosi në votim shqyrtimin dhe miratimin e strategjisë së modernizimit të QNR-ës, më vërejtjet dhe plotësimet që duhet të behën në të.

**Samir Kurteshi:** Megjithë, pas diskutimeve që i dëgjuam dhe vërejtjet që ishin disa të pranuar dhe disa të papranuara, unë propozoj më e marr dhe më e ripunuar. Unë, jam i obliguar ta hedh në votim...

**Samir Hamiti:** Kur unë nuk ndërruar asnjë vendim kjo është mungesë dhe nuk duhet të sillni kështu punën që në atë moment unë të dal jashtë, unë nuk po votoj pro, nuk votoj kundër, unë do me than nuk jam pjesë e votimit, dhe ti tani po me thua ke qenë këtu, dil jashtë pastaj e rregullojmë...Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, me dy vota kundër, miratuan strategjinë për modernizimin e QNR-së.

## 2. Analiza e Sekretariatit për të gjeturat dhe vendimet e PZAP-it në trajtimin e fletvotimeve të vlefshme, dhe të pavlefshme:

**Alim Rama:** Keni para jush një analizë të berë nga Sekretariati për të gjeturat dhe vendimeve të PZAP-it në trajtimin e Fletëvotimeve të vlefshme, dhe të pavlefshme. Raporti është në detaje kështu që unë nuk i kisha hyr në detaje. Analiza i ka trajtuar të gjitha vendimet e PZAP-it në lidhje me flet votimet të vlefshme ose të pavlefshme si rrjedhojë e zgjedhjeve të 6 tetorit, po ashtu e keni si kërkesë kopjen dhe mostrat e vendimeve që ka marr PZAP-it, kështu që unë kisha shkuar në rrumbullakësim që të gjitha fletëvotimet dhe nga ankesat i kemi që 53% të ankesave që janë shpallur të vlefshëm dhe dihet qellim, në 53% të rasteve në të gjitha ankesat fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm sepse nuk është qëllimi i sakët, 27% fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm, do me than është i dëmtuar qëllimisht 7% dhe 13% prej tyre pasi që ankesa është refuzuar pasi vendvotimi nuk ekziston.

Këto janë analizat faktike kështu që për mua të gjeturat janë shumë interesante ku kemi pasur edhe disa vendime të PZAP-ës të cilat në kundërshtim me rregulloren e KQZ-ës dhe në kundërshtim me doracakun i kanë anuluar disa fletëvotime për shkaqe që në interpretimin e PZAP-ës, X brenda pakos e shpall pavlefshmërinë e cila është në kundërshtim 100% me doracakun, me manual ku aty kemi çfarëdo shënim brenda kutisë apo brenda rreshtit, e përcakton intencën e votuesit.

Këshilli për operacione zgjedhore, rekomandon për aprovimin e kësaj analize dhe këtu janë disa rekomandime të qarta që janë në faqe 17, të krijuar një standard unik të klasifikimit të fletëvotimit në të vlefshme dhe jo të vlefshme për këtë do të formohet komisioni i cili do të bëjë përgatitjen të formës unike të paraqitjes së vlefshmërisë dhe të pavlefshmërisë të fletëvotimeve. Rekomandojmë që gjatë trajnimit që ti kushtohet kujdes ngritjes e kapacitetit dhe pergjithshmeritë të anëtareve të KVV-e në rast të mos pajtimit që mund të ndodhin në procesin e numërimit, për të ngritur profesionalizimin e anëtareve, duke u bazuar në raportin e komisionit të përkohshëm na duhet inkorporohen në doracakun për procedurat e votimit dhe numërimit, rekomandimi i krijimit të standardit unik duhet të pasur lapsa për të shënuar fletëvotimin me ngjyra të ndryshme.

Po shihet që raporti, nuk i ka marr vërejtje që janë dhënë në Këshill për Operacione Zgjedhore që të përfshihet dhe mundësia e lapsave e ngjyrave tjera që të ketë një analizë, po ashtu, disa rekomandime për intervenimin e manualin ose doracakun për zgjedhjet lokale të ndryshohet sipas udhëzimeve administrativ të votuesve që do të më thanë të pasurohet me disa shembuj dhe mostra tjera të fletëvotimit të vlefshme dhe të pavlefshme, rekomandimi që rrjedh për doracak nga analiza e votave me asistencë, ka qenë dhe një rekomandim që u aprovua atje, ka qenë që me tavolinat, me posterat. Kemi definuar madhësinë e posterave, që posterat në tavolinat e numërimit që të jenë të qarta, ku ka me qenë mostra e qartë ku tregojnë cilat janë fletëvotimet e vlefshme dhe ato të pavlefshme dmth, shënimi i fletëvotimeve brenda që të kenë të qarta të gjithë ata që marrin pjesë në numërimin e votave po ashtu edhe në vendvotime, dhe në QNR që të kenë para vetës si shembull cilat votime pranohen dhe cilat jo.

Me rekomandimet e KOZ-it, KOZ-i ka rekomanduar këtë analizë që të aprovohet. Si rrjedhojë e kësaj analize pastaj do të jetë intervenimi në doracak.

**Sami Hamiti:** Unë, e hapi diskutimin. Z. Rama qartë e dha së çfarë është diskutuar në KOZ po ashtu dhe sugjerimet që pas kësaj analize, duhet të intervenohet edhe në doracakun.

**Eshref Vishi:** Unë, e dëgjova me kujdes paraqitjen e KOZ-it këtu mirëpo, diçka nuk po përputhet nëse eventualisht jam gabim, unë e kam fjalën të rekomandimet, të rekomandimi nr. 1 thotë “të krijuar një komision i cili në dakordim të bëjë përgatitjen e formës unike të paraqitjes së vlefshmërisë apo pavlefshmërisë të fletëvotimeve”, e në anën tjetër janë dhënë rekomandimet për intervenim në doracak. Do të më thanë, nëse formohet komisioni, dhe komisioni e ban grupizimin e fletëvotimit së çka konsiderohet e vlefshme dhe çka e pavlefshme, kështu që nuk ka kuptim që të intervenohet tani për tani në doracak mirëpo të pritet puna e këtij komisionit.

Tek rekomandimi nr.2, shpallja e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme konsiderohet si pasojë direktë jo e profesionalizimit të anëtarëve të KVV-es, rekomandojmë që gjatë trajnimit që ti kushtohet kujdes ngritjes së kapaciteteve dhe

te përgjegjshmeris profesionale të anëtarëve të KVV-ës në raste të mos pajtimeve të cilat ndodhin në procesin e numërimit e fletëvotimeve.

Unë, kujtoj që shumë pak mundet me ba KQZ-ja në këtë drejtim për arsye se duhet informimi së prej nga vinë anëtarët e KVV-ës apo komisionarët. Ndërsa deri sa të partia politike në rastin e caktimit të komisioneve nuk hiqet kriteri social është shumë problematike më e ngrit profesionalizmin të anëtareve të KVV-ës ose eventualisht nuk ju nënshtrohet ligji proces ndryshimit ne kuptimin e përbërjes së KVV-e. Për ta ngritur profesionalizmin e anëtareve të KVV-ës rekomandoj të jetë një trup permanente: s'i mendoni të realizoni KVV-n që trup permanente e cila, do të duhej trajnohet në vazhdimësi, po të ishte trup permanente ne e dimë se kush janë anëtarët e KVV-ës dhe anëtarët e KVV-ës janë me mandat 4 vjet dhe brenda 4 vjetëve ka zgjedhje nacionale apo lokale dhe ata në vazhdimësi mund të trajnohen, ne nuk e dimë se cilët antëtarët të KVV-ës do të jenë anëtarë të KVV-ës dmth, të propozuarit e partive politike në këto zgjedhje apo në zgjedhje tjera, unë nuk mendoj që e ka vendin ky rekomandim këtu.

**Sami Hamiti:** Rekomandimet që i ka dhanë në analizë nuk do me than që duhet me u ba ajo punë, një kërkesë e jon ka qenë që p.sh, duhet patjetër me be një sekretar të këshillit të vendvotimit më qenë shembull një punëtor i administratës direkt që e merr përsipër dhe nuk është politik, por nuk është realizuar. Kur e rekomandojmë, nuk do te thotë që do e miratojmë sepse kjo është një analizë që i jep disa rekomandime. Nuk është e thane as qe kemi me pas mundësi me bë ne atë shabllonin unik, se ne edhe ne këto zgjedhjet e parafundit ju e dini shumë mirë kur e kemi ber doracakun që jemi ulur bashkërisht që cilin fletëvotim e kemi vendos me një analizë bashkërisht dhe, kemi vendos cila duhet te trajtohet realisht e rregullt dhe cila e pa rregullt.

Analiza si analizë është e mirë, tash rekomandimet që vinë pjesa çka mundet të behët dhe pjesa që duhet te behet në doracak patjetër dhe mundësit që i jep propozim që me u be diçka që do te mundet të behet ajo trup e përhershme është diçka që të ne për një kohë nuk mund të bahet.

**Eshref Vishi:** Unë nuk e kontestova analizën fare, me vjen mirë që e kanë përgatitur sepse është në mënyrë profesionale po ashtu mbi bazën e argumenteve ë janë zhvilluar proceset zgjedhore dhe te gjeturat të cilat janë gjatë proceseve zgjedhore këtu për tu formimi i komisionit profesional do ta kishte kuptimin e formimit e një komisionit profesional në QNR dhe të gjitha rastet e KVV-e të cilat ngritën ne debate mes subjekteve politike për arsye së anëtarët e KVV-e pse janë profesional ato vinë nga subjektet politike dhe mbrojnë interesin e vet, fjalën përfundimtare me pas komisioni për vlefshmërinë e fletëvotimeve që është për ose kundër në mënyrë që të jetë tepër profesional dhe objektiv për trajtimin e këtyre problemeve, në mënyrë qe ta minimizon mundësin e ankimit të subjekteve politike në PZAP, dhe mos te kemi ankesa të njëjta të subjekteve politike sa i përket fletëvotimeve.



**Alim Rama:** Kjo është një element që kish pas mundësi me qenë pjesë e strategjisë e modernizimit të QNR-ës, në qoftë se ekziston një komision teknik i cili i tregon në poster kjo ka qenë e vlefshme kjo e pavlefshme atëherë e minimizon numrin, ai ka qenë dhe qëllimi. Në qoftë se, është një komision teknik që përbehet prej drejtorit të operacioneve, menaxherit, drejtoreshës së trajnimeve, 4 ose 5 staf profesional teknik i cili është komisioni i cili i vlerëson këto. Unë kisha edhe një pyetje. A janë shumica e fletëvotimeve që janë kundërshtuar në QNR?

**Valbona Kida:** Qëllimi i kësaj analize ka qenë më përforcuar një parim objektiv në vlerësimin e qëllimit të qartë të votuesit, baza ka qenë shumë e mirë dhe është shumë e mirë përderisa ne e kemi në nenin 20,20.8 dhe 20.10 që përcakton vlefshmërinë dhe pavlefshmërinë e fletëvotimeve. Këto mos pajtime, po ndodhin prej këshillave të vendvotimeve e deri në instancat gjyqësore, duke kaluar në qendër të numërimit edhe pse ka raste që në bazë të vendimeve vlerësimeve subjektive neve na shkaktohen probleme prej këshillit të vendvotimit në QNR, prej QNR-ës tek PZAP-i, prej PZAP-it në instanca tjera gjyqësore, mirëpo qëllimi është që ne me e vendos standardin që me pas mundësi me e vlerësua në mënyrë objektive. E, sa i përket rekomandimit të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe krijimit të një trupe të këshillat e vendvotimeve, i kam pas për bazë 2 indikator që me kanë shty me përsërit këtë rekomandim sepse, është shumë me rëndësi që një kualifikim që ajo është instancë shumë e rëndësishme sepse, këshillat e vendvotimeve i implementojnë këto procedura që ne i mësojmë hap pas hapi prej trajnerëve e deri atje. Kemi pasur raste kur kemi marrë disa fragmente nga kodi penal që ka ekzistuar një lloj frike dhe e kanë pa që është një përgjithësi shumë e madhe dhe janë tërhequr disa kryesës.

Mirëpo, kjo po ndërlidhet edhe me krijimin e kësaj trupe permanente, unë e kam pas qëllimin që me ekzistua mekanizëm me i fort në mes KQZ-ës dhe subjekteve politike. E kam për bazë një trajnim në vitin 2016, e kemi zhvilluar prej 3 anëtareve në të gjitha komunat prej secilit subjekt të përfaqësues, e kemi zhvilluar një trajnim lidhje më të gjitha këto proceduara që ata ballafaqohen në ditën e zgjedhjeve, sa me disa departamente të tjera kemi pasur njohuri të përgjithshme se me çka punohet në KQZ. Qëllimi i atij projektit ka qenë që këta potencialisht me qenë në të ardhmen antëtar të këshillave të vendvotimeve. Që nga 2016 nuk janë organizuar trajnime të tilla, qëllimi është që në të ardhmen neve të bëjmë projektet të tilla që ti vejmë në funksion që edhe me subjektet politike, me OJQ-ët, me mediat dhe, me të gjithë akteret të cilët janë pjesë e ditës së zgjedhjeve dhe procesi se çfarë ka ndodhur ditën e zgjedhjeve.

Në këtë mënyrë, kjo trupa permanente nëse ne i mbajmë disa trajnime do të ishin gjithmonë persona potencial për të punuar në zgjedhje edhe pse ne kemi të tillë shumica e këshillave të anëtareve punojnë kohë të gjatë, e sa i përket kualifikimit të tyre unë jam në proces të punimit të një projektit për të gjeturat e në trajnim që janë shumë aspekte politike që edhe nga zyrtaret komunal që aty, ekziston një normë ligjore se si ata nominohen dhe si emërohen këto. Mundësia jonë, është se sa

ne mundemi më i mësuar ato kategori të personave, se a ka fakultet a po nuk ka, ajo me ligj është e përcaktuar...

**Sami Hamiti:** Problemi është që trupa zgjedhore permanente e këshillave të vendotimeve që të behën ne formatin e përhershëm permanent duhet që të ndërrohet ligji, ligji i zgjedhjeve i cili është larg, intenca me qenë një kërkesë e me hershme që ka qenë në forcim të procesit zgjedhor që të ketë një sekretar të këshillit të vendotimit i cili është a partiak, është nga administrata shtetërore...

A, ka dikush tjetër rreth kësaj të diskutoj. Kush është që të aprovohet?

**Alim Rama:** Unë, mendoj që kjo zgjedhja e këtyre vlerësimeve që i kanë bërë stafi i QNR-ës, kanë treguar që nuk janë të paanshëm, se disa shembuj që i pash unë këtu janë totalisht absurde. Pastaj, unë mendoj që kjo nuk ka të bej me profesionalizëm këtu ka të bej më diçka tjetër.

**Sami Hamiti:** Tani, po flasim për zgjedhjet e fundit sepse ju në zgjedhjet nacionale nuk ke qenë sepse procesi i numërimit ka qenë ma i keqi dhe pikërisht është ber nga subjektet politike, por unë nuk po dua që ti i dha emrat e tyre se cilat parti ka qenë. Prandaj ne finale nuk i kanë vlerësuar hiq ata po i ka vlerësuar stafi profesional i QNR-ës. Sepse kanë hyr anëtar të KQZ-ës kanë ber vlerësime, kanë hyr edhe pjesë politike disa si vizitor dhe disa si anëtar i kanë prishur disa fletëvotime. Edhe kemi ardhur në një situatë që me marr një qëndrim këtu në KQZ që anëtarët. KQZ-ës, dhe pjesa tjetër që të mos hyn më i prek, po me shkua drejtpërdrejt të shefi i QNR-ës që të vlerësohet, edhe pjesa tjetër... Kush është për votimin e kësaj analize...?

**Eshref Vushi:** Qëllimi i shqyrtimit të një dokumentit që vije këtu ne tavolinën ton është vlerësimi i punës që e kanë ber sekretariati mbi bazën e planit edhe objektivat që kanë para vetës, këtu e kanë sjell një produkt, këtu e kanë sjell dhe një material që është në bazën e shqyrtimit dhe miratimit të tij. Në anën tjetër do të ishte mirë që ne të mos ofendohemi dhe te kemi një respekt ndaj njeri tjetrit këtu dhe jo të kemi paragjykimë. Qëllimi i kësaj analize, është zvogëlimi i fletëvotimeve të vlefshme në QNR, dhe kjo nuk ka kuptim fare. Sepse, ky material që e kemi ne para vetës nuk është produkt dhe prodhim që e kanë be këta anëtar mirëpo i kanë marrur të gjitha fletëvotimet, një mostër të fletëvotimeve që janë qenë objekt i ankesave në PZAP edhe në gjykatën supreme, dhe përveç një analize që është bërë se, arsyet janë këto, asgjë tjetër nuk ka as një qëllim tjetër nuk ka këtu. Prandaj, duhet të kursehem ndaj njëri tjetrit...

**Sami Kurteshi:** Shumë mirë, edhe unë jam t'i zbërthejmë gjërat deri në fund, me këtë pajtohem – me atë s'pajtohem...! Fyese është për administratën nëse, dikën e vlerësojmë me notë maksimale, e dikën me notë minimale...

**Sami Hamiti:** Këtë fletëvotim me X në katror e ke në doracak që partitë politike dhe anëtarët e ton duke me përfshirë edhe mua po ashtu edhe ata të VV-ës kemi votuar që është në rregull. Është votë e rregullt sepse komision e kemi vendosur.

Faleminderit. Vazhdojmë më shqyrtimin dhe miratimin e projektit. Kush është kundër? Vazhdojmë më pikën e 3-të shqyrtimi dhe miratimin e projektit për punëtorin e përbashkët.

Në fund të një debati të gjatë në shqyrtimin e kësaj pike, anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë analizë të Sekretariatit.

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit- punëtori e përbashkët për mësimet e nxëna për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut:

**Alim Rama:** KQZ-ja duhet me ber mësimet që të vlerësoj procesin e kaluar, raporti ka qenë propozimi i... dmth, të organizohet një punëtori e përbashkët që temat e analizës procesit zgjedhor ne Podujevë dhe në Mitrovicën e Veriut, i keni objektivat dhe se cilat prezantime pritet të paraqiten këtu. Këtu kemi vetëm një problem që sekretariati nuk ka qenë në gjendje të siguroj një objekt apo hotel për shkaqe te pandemisë. Kështu që unë rekomandoj në qoftë se nuk gjendje sekretariati që brenda një kohës të arsyeshme, se për shkak të rëndësi së procesit të mësim nxenjës, mundemi m e toleruar dhe te votojmë pas viti të ri nëse nuk do kishte qenë problem. Edhe një alternativ tjetër që të përdoret salla e ombuspersonit, pasi që nuk janë në gjendje që ta sigurojnë objektin ku duhet. Unë mendoj që ky aktivitet, është shumë i rëndësishëm...

**Sami Hamiti:** Unë pajtohem që më simet e nxena duhet të behën, a sigurohet hotel a jo ose ndonjë sallë. A mundet me u be që më u siguruar në janar? Kështu që mire është më qenë janari. A jeni për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë projekt-punëtori.

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Pagesat e KVV-ve dhe stafit teknik për angazhimin e tyre me datën 14 mars 2020 në Komunën e Podujevës:

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës është nga këshilli për buxhet dhe financa, e kemi pasur ne rend të ditës e hoqëm nga rendi i ditës, do i shqyrtojmë në mbledhjen e radhës së KQZ-ës dhe plotësimet që janë kërkuar, kurse tjetra është teknike: pagesat e KVV-e dhe stafit teknik për angazhimin e tyre me 14 mars të vitit 2020 në komunën e Podujevës.

Përveç kësaj, edhe një pjesë mjeteve që kanë mbetur në zgjedhjet e 2019 që ishin 33 persona në të gjitha komunat, që kanë mbetur pa u ber pagesat për shkaqe të problemeve që kanë pasur në llogari edhe tjetër ne këshilli për buxhet e kemi votuar dhe e dimë që data 14 ka ndodhur për shkak se, shtymja e zgjedhjeve ka ndodhur që ai staf duhet të jetë i angazhuar për materialet që janë esenciale dhe duhet të i pranojë në zgjedhje.

Kështu që ata njerëz atë ditë kanë qenë të angazhuar dhe jemi të obliguar që ti bëjmë pagesat. Fatmirësisht, edhe ne koston financiare ka mjete sepse nuk ka pasur shpenzime shumë, kjo e mira që mjete ka dhe nuk ka problem për mjete për kosto financiare. A

keni dikush vërejtje apo sugjerime rreth kësaj? Atëherë kush është për që të ju kryhen këto pagesa?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto pagesa.

**1. Të ndryshme.**